



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEČAN ZVEČAN MUNICIPALITY			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	CO	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	P-6-2/26
Nr. lfaqeve Br. stranica No. pages	7	Data Datum Date	25.06.2026



Opština Zvečan
Komuna e Zveçanit
Municipality of Zvečan

ЗАПИСНИК

са 6. (шесте) редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години

Шеста редовна седница Скупштине општине Звечан у 2026. години одржана је дана 25.06.2026. године, са почетком у 11.00 часова у скупштинској сали општине Звечан.

Седницом је председавао др Срђан Милосављевић, председавајући Скупштине општине Звечан. Председавајући је у уводном обраћању поздравио градоначелника господина Драгишу Миловића, заменика градоначелника Ивана Тодосијевића, представнике Министарства администрације и локалне самоуправе (МАЈС), представнике медија, међународних организација, директоре одељења, запослене у општинској администрацији и присутне грађане.

Након позива председавајућег, административни службеник Скупштине општине, господин Милош Недељковић, известио је о присуству одборника. Констатовано је да седници присуствује 13 одборника.

Седници су присуствовали следећи одборници :

1. Предраг Радовановић
2. Јасминка Млађовић
3. Иван Васић
4. Часлав Софронијевић
5. Марија Јовановић
6. Срђан Милосављевић
7. Милош Радосављевић
8. Лука Јовановић
9. Радомир Вучовић
10. Јелена Никић
11. Радосав Радомировић

12. Зоран Обреновић

13. Iir Peci

Седници нису присуствовали:

1. Бранислав Милић и

2. Ивана Ђокић

Председавајући је, на основу члана 46. Закона о локалној самоуправи, констатовао да постоји потребан кворум за рад и пуноправно одлучивање.

Навео је да су одборници, уз позив за седницу, добили и предложени дневни ред, који се састојао од четири тачке.

Дневни ред:

1. Усвајање записника са 5. (пете) редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години;
2. Разматрање и доношење одлуке о усвајању Средњорочног оквира буџета општине Звечан за период 2027-2019 године;
3. Разматрање и доношење одлуке о усвајању Општинске уредбе о одређивању радног времена привредних субјеката који обављају своје делатности на територији општине Звечан;
4. Разно

Пошто није било предлога за допуну предложени Дневни ред је стављен на гласање и усвојен је једногласно.

Тачка 1.

Усвајање записника са 5. (пете) редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години

Председавајући је позвао одборнике да изнесу евентуалне примедбе на записник. Како није било примедби, председавајући је ставио на гласање предлог за усвајање записника са 5. редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години.

Након спроведеног гласања, председавајући је констатовао да није било гласова против, нити уздржаних, те да је записник са 5. редовне седнице Скупштине општине Звечан једногласно усвојен.

Тачка 2.

Разматрање и доношење одлуке о усвајању Средњорочног оквира буџета општине Звечан за период 2027-2029. године

Председавајући је отворио тачку дневног реда која се односи на разматрање и усвајање Средњорочног оквира буџета општине Звечан за период 2027–2029. године.

Средњорочни оквир буџета општине Звечан за период 2027–2029. године представила је Мирјана Алагић, директорица Одељења за буџет и финансије, која је одборнике упознала са основним елементима предложеног документа, финансијским оквирима, приоритетима финансирања, као и значајем овог документа за планирање буџета општине Звечан у наредном трогодишњем периоду.

Након представљања Средњорочног оквира буџета, председавајући је отворио расправу. Како се нико од одборника није јавио за реч, констатовано је да није било расправе по овој тачки дневног реда.

Председавајући је након тога ставио на гласање предлог Одлуке о усвајању Средњорочног оквира буџета општине Звечан за период 2027–2029. године.

Након спроведеног гласања, констатовано је да је предлог усвојен са 12 гласова „ЗА“ и 1 гласом „ПРОТИВ“.

Председавајући је констатовао да је Скупштина општине Звечан усвојила Средњорочни оквир буџета Општине Звечан за период 2027–2029. године и донела Одлуку о усвајању Средњорочног оквира буџета Општине Звечан за период 2027–2029. године.

Средњорочни оквир буџета и донета Одлука чине саставни део овог записника.

Тачка 3.

Разматрање и доношење одлуке о усвајању Општинске уредбе о одређивању радног времена привредних субјеката који обављају своје делатности на територији општине Звечан

Председавајући је отворио тачку дневног реда која се односи на разматрање и доношење Одлуке о усвајању Општинске уредбе о одређивању радног времена привредних субјеката који обављају своје делатности на територији општине Звечан.

По овој тачки дневног реда известилац је био директор Одељења за економски развој, Милан Радомировић. Он је одборнике упознао са садржином предложене уредбе и указао на потребу доношења новог акта којим би се на јасан и свеобухватан начин уредило радно време привредних субјеката који обављају делатност на територији општине Звечан.

У свом излагању, известилац је истакао да је доношење ове уредбе значајно ради унапређења правне сигурности, боље организације рада привредних субјеката, као и ради усклађивања њиховог радног времена са потребама грађана и локалне заједнице.

Такође је наглашено да су у поступку израде уредбе током организоване јавне консултације, активно учествовали грађани и представници привредних субјеката, чији су предлози, сугестије и примедбе разматрани приликом припреме коначног текста уредбе.

Након излагања известиоца, председавајући је отворио расправу. Како се нико од одборника није јавио за реч, констатовано је да није било расправе по овој тачки дневног реда.

Председавајући је након тога ставио на гласање предлог Општинске уредбе о одређивању радног времена привредних субјеката који обављају своје делатности на територији општине Звечан.

Након спроведеног гласања, председавајући је констатовао да је Скупштина општине Звечан усвојила Општинску уредбу о одређивању радног времена привредних субјеката који обављају своје делатности на територији општине Звечан.

Општинска уредба чини саставни део овог записника.

Тачка 4.

Разно

Председавајући је отворио расправу по тачки „Разно“ и позвао одборнике да се јаве за реч.

Како се нико од одборника није јавио за реч, присутнима се обратио градоначелник др Драгиша Миловић. Он је најпре поздравио председавајућег, одборнике, представнике међународних мисија и медија, а затим се осврнуо на питање од значаја за српску заједницу, које је, како је навео, већ привукло пажњу јавности.

Градоначелник је истакао да су 17. јуна представници Европске уније, амбасада земаља Квинте и Мисије ЕУЛЕКС упутили допис властима у Приштини, којим је затражено да се припадницима мањинских заједница омогући и обезбеди остваривање Уставом загарантованог права на употребу националних симбола и застава. Посебно је нагласио да је у том допису право на употребу националних обележја и застава означено као уставна категорија која се мора поштовати.

У наставку излагања подсетио је да представници српске заједнице већ годинама указују на угроженост основних људских и демократских права, укључујући и права гарантована Уставом, међу којима је и право на употребу националних симбола и застава. Тим поводом јавно је изразио захвалност представницима Европске уније, амбасадорима земаља Квинте и шефу мисије ЕУЛЕКС на упућеном допису, оцењујући га као први позитиван корак који може допринети стабилизацији прилика.

Као пример проблема са којима се суочавају припадници српске заједнице навео је дешавања на Газиместану, где су, према његовим речима, претходних година привођени младићи због ношења мајица са националним обележјима, застава Републике Србије или верских мотива, што је полиција тумачила као провокацију.

На крају излагања градоначелник је изразио очекивање да ће предстојеће обележавање Видовдана протећи мирно и достојанствено, као и да ће припадници српске заједнице моћи несметано да обележе празник и користе своја национална обележја у складу са Уставом загарантованим правима, без привођења и других инцидената.

Председавајући се захвалио градоначелнику на обраћању.

Након тога, за реч се јавио одборник Часлав Софронијевић. Он је поставио питање да ли је Општина Звечан упозната са радовима који се већ извесно време изводе на простору Дудиног крша. Навео је да су на том локалитету уклоњене дивље депоније, што је оценио као позитиван потез, упутивши похвале лицима која су извела чишћење тог простора. Истовремено је нагласио да сваки инвеститор или привредни субјект који обавља делатност на територији општине треба да поступа у складу са важећим прописима и да своје активности реализује у сарадњи са локалном самоуправом.

Одборник Софронијевић је у наставку поставио питање у вези са постављањем табли са називима улица, наводећи да је на улазу у село Мало Рударе постављена табла са именом

албанске личности. Изразио је став да је приликом одређивања назива улица од стране претходне власти требало узети у обзир националну структуру становништва тог села, имајући у виду да је реч о месту са већинским српским становништвом. Додао је да су му се грађани обраћали са питањима у вези са наведеним називом улице, због чега је затражио образложење о разлозима за постављање те табле на наведеној локацији.

Одговарајући на постављена питања, градоначелник др Драгиша Миловић навео је да је, према информацијама добијеним од директора Дирекције за урбанизам, Министарство инфраструктуре још 2024. године расписало јавни оглас за закуп парцеле површине 6.800 m² на простору Дудиног крша. Према расположивим информацијама, наведена локација предвиђена је за изградњу полигона за обуку кандидата ауто-школа.

Градоначелник је истакао да нема сазнања да ли су претходно руководство општине, претходни градоначелник или Скупштина општине били упознати или консултовани у вези са тим поступком. Додао је да, према информацијама којима располаже, општина Звечан од тог закупа нема никакву финансијску корист, док је уговор о закупу закључен на период од двадесет година, уз могућност продужења.

У наставку је градоначелник поново указао на проблем прекомерне централизације одлучивања и ограничених надлежности локалне самоуправе. Посебно је нагласио да Општина Звечан и даље није у могућности да користи средства из свог буџета, јер поједини службеници још увек нису стекли неопходне сертификате, што значајно успорава реализацију инфраструктурних пројеката. Подсетио је да су за инфраструктуру планирана одређена средства, али да она још нису доступна за коришћење.

Такође је навео да је општина Звечан више пута тражила помоћ од Министарства за локалну самоуправу ради превазилажења административних проблема. Подсетио је да је у претходном периоду буџетске послове за општину Звечан обављала друга општина, док сада такво решење није прихваћено. Изразио је очекивање да ће надлежне институције у наредном периоду омогућити несметано функционисање локалне самоуправе, како би грађани могли благовремено да остварују своја права и користе услуге општине.

Након тога, за реч се јавио одборник Илир Пеци. Он се осврнуо на више инфраструктурних пројеката реализованих у периоду од 2010. до 2012, наводећи да, према његовим сазнањима, поједини пројекти који су у документацији евидентирани као завршени у пракси нису у потпуности реализовани. Као примере навео је поједине путеве, паркинг-просторе и инфраструктурне радове у појединим селима, изражавајући сумњу у начин реализације и евидентирања тих пројеката.

Поводом навода одборника Пеција, градоначелник др Драгиша Миловић истакао је да није доводио у питање рад претходног руководства, већ да је искључиво одговарао на питање


које се односило на радове на простору Дудиног крша. Додао је да је обишао више села на територији општине и да су поједини реализовани пројекти квалитетно изведени. Ипак, нагласио је да је инфраструктура на територији општине у целини дотрајала и да су неопходна нова улагања. Такође, рекао је да уколико одборник Пеци има доказе о одређеним пројектима који нису реализовани, а евидентирани су кроз папире да те доказе треба да преда тужилаштву.

Како се више нико није јавио за реч, председавајући је констатовао да је дневни ред исцрпљен и закључио шесту редовну седницу Скупштине општине Звечан, која је завршена у 11.51 часова.

У Звечану,

Дана: 25.06.2026.

Записничар:



Милош Недељковић, мастер правник,
административни асистент Скупштине

Председавајући Скупштине

општине Звечан



Др. Срђан Милосављевић



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEČAN ZVEČAN MUNICIPALITY			
Njësi Org. Org. Jed.in. Org. Unit.	CO	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	P-6-2/26
Nr. i faqeve Br. strahica No. pages	7	Data Datum Date	25.06.2026



Opština Zvečan
Komuna e Zveçanit
Municipality of Zvečan

PROCESVERBAL

nga seanca e 6-të (e gjashtë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026

Seanca e gjashtë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026 u mbajt më datë 25.06.2026, me fillim në orën 11:00, në sallën e kuvendit të Komunës së Zveçanit.

Seancën e kryesoi dr. Srđan Milosavljević, kryesues i Kuvendit të Komunës së Zveçanit. Në fjalën hyrëse, kryesuesi përshëndeti kryetarin e komunës, z. Dragiša Milović, nënkryetarin e komunës Ivan Todosijević, përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përfaqësuesit e mediave, të organizatave ndërkombëtare, drejtorët e drejtorive, të punësuarit në administratën komunale dhe qytetarët e pranishëm.

Me ftesë të kryesuesit, zyrtari administrativ i Kuvendit Komunal, z. Miloš Nedeljković, raportoi për praninë e këshilltarëve. U konstatua se në seancë marrin pjesë 13 këshilltarë.

Në seancë morën pjesë këta këshilltarë:

1. Predrag Radovanović
2. Jasminka Mlađović
3. Ivan Vasić
4. Časlav Sofronijević
5. Marija Jovanović
6. Srđan Milosavljević
7. Miloš Radosavljević
8. Luka Jovanović
9. Radomir Vučović
10. Jelena Nikić
11. Radosav Radomirović

12. Zoran Obrenović

13. Ilir Peci

Në seancë nuk morën pjesë:

1. Branislav Milić dhe
2. Ivana Đokić

Kryesuesi, në bazë të nenit 46 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, konstatoi se ekziston kuorumi i nevojshëm për punë dhe vendimmarrje të plotfuqishme.

Ai theksoi se këshilltarët, së bashku me ftesën për seancë, kanë marrë edhe rendin e propozuar të ditës, i cili përbëhej nga katër pika.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e 5-të (e pestë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026;
2. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027-2029;
3. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për miratimin e Rregullores Komunale për përcaktimin e orarit të punës të subjekteve ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Zveçanit;
4. Të ndryshme

Meqenëse nuk pati propozime për plotësimin e rendit të propozuar të ditës, Rendi i Ditës u hodh në votim dhe u miratua njëzëri.

Pika 1.

Miratimi i procesverbalit nga seanca e 5-të (e pestë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026

Kryesuesi i ftoi këshilltarët të paraqesin vërejtjet eventuale lidhur me procesverbalin. Meqenëse nuk pati vërejtje, kryesuesi e hodhi në votim propozimin për miratimin e procesverbalit nga seanca e 5-të e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026.

Pas votimit të zhvilluar, kryesuesi konstatoi se nuk pati vota kundër, as të përmbajtur, dhe se procesverbali nga seanca e 5-të e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit u miratua njëzëri.

Pika 2.

Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027-2029

Kryesuesi hapi pikën e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027-2029.

Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027-2029 e prezantoi Mirjana Alagić, drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, e cila i njoftoi këshilltarët me elementet kryesore të dokumentit të propozuar, kornizat financiare, prioritetet e financimit, si dhe rëndësinë e këtij dokumenti për planifikimin e buxhetit të Komunës së Zveçanit në periudhën e ardhshme trevjeçare.

Pas prezantimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, kryesuesi hapi diskutimin. Meqenëse asnjë nga këshilltarët nuk u paraqit për fjalë, u konstatua se nuk pati diskutim për këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi më pas e hodhi në votim propozimin e Vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027-2029.

Pas votimit të zhvilluar, u konstatua se propozimi u miratua me 12 vota “PËR” dhe 1 votë “KUNDËR”.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Komunës së Zveçanit miratoi Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027-2029 dhe mori Vendimin për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027-2029.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Vendimi i marrë janë pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pika 3.

Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për miratimin e Rregullores Komunale për përcaktimin e orarit të punës të subjekteve ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Zveçanit

Kryesuesi hapi pikën e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin dhe marrjen e Vendimit për miratimin e Rregullores Komunale për përcaktimin e orarit të punës të subjekteve ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Zveçanit.

Për këtë pikë të rendit të ditës raportues ishte drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Milan Radomirović. Ai i njoftoi këshilltarët me përmbajtjen e rregullores së propozuar dhe theksoi nevojën për miratimin e një akti të ri, me të cilin do të rregullohej në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse orari i punës i subjekteve ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Komunës së Zveçanit.

Në fjalën e tij, raportuesi theksoi se miratimi i kësaj rregulloreje është i rëndësishëm për avancimin e sigurisë juridike, organizimin më të mirë të punës së subjekteve ekonomike, si dhe për harmonizimin e orarit të tyre të punës me nevojat e qytetarëve dhe të komunitetit lokal.

Gjithashtu u theksua se gjatë hartimit të rregullores, në kuadër të konsultimit publik të organizuar, kanë marrë pjesë aktivisht qytetarët dhe përfaqësuesit e subjekteve ekonomike, propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e të cilëve janë shqyrtuar gjatë përgatitjes së tekstit përfundimtar të rregullores.

Pas fjalës së raportuesit, kryesuesi hapi diskutimin. Meqenëse asnjë nga këshilltarët nuk u paraqit për fjalë, u konstatua se nuk pati diskutim për këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi më pas e hodhi në votim propozimin e Rregullores Komunale për përcaktimin e orarit të punës të subjekteve ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Zveçanit.

Pas votimit të zhvilluar, kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Komunës së Zveçanit miratoi njëzëri Rregulloren Komunale për përcaktimin e orarit të punës të subjekteve ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Zveçanit.

Rregullorja Komunale është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pika 4.

Të ndryshme

Kryesuesi hapi diskutimin për pikën “Të ndryshme” dhe i ftoi këshilltarët të paraqiten për fjalë.

Meqenëse asnjë nga këshilltarët nuk u paraqit për fjalë, të pranishmëve iu drejtua kryetari i komunës, dr. Dragiša Milović. Ai fillimisht përshëndeti kryesuesin, këshilltarët, përfaqësuesit e misioneve ndërkombëtare dhe të mediave, ndërsa më pas iu referua një çështjeje me rëndësi për komunitetin serb, e cila, siç theksoi, tashmë ka tërhequr vëmendjen e opinionit publik.

Kryetari i komunës theksoi se më 17 qershor përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, ambasadave të vendeve të Kuintit dhe Misionit EULEX u kanë dërguar autoriteteve në Prishtinë një shkresë, me të cilën është kërkuar që pjesëtarëve të komuniteteve pakicë t'u mundësohet dhe sigurohet realizimi i së drejtës së garantuar me Kushtetutë për përdorimin e simboleve dhe flamujve kombëtarë. Ai theksoi veçanërisht se në atë shkresë e drejta për përdorimin e shenjave dhe flamujve kombëtarë është përcaktuar si kategori kushtetuese që duhet të respektohet.

Në vazhdim të fjalës së tij, ai rikujtoi se përfaqësuesit e komunitetit serb tash e shumë vite po tregojnë për cenimin e të drejtave themelore njerëzore dhe demokratike, përfshirë edhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, ndër të cilat është edhe e drejta për përdorimin e simboleve dhe flamujve kombëtarë. Me këtë rast, ai shprehu publikisht falënderimin ndaj përfaqësuesve të Bashkimit Evropian, ambasadorëve të vendeve të Kuintit dhe shefit të Misionit EULEX për shkresën e dërguar, duke e vlerësuar atë si hapin e parë pozitiv që mund të kontribuojë në stabilizimin e gjendjes.

Si shembull të problemeve me të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit serb, ai përmendi ngjarjet në Gazimestan, ku, sipas fjalëve të tij, në vitet e kaluara janë ndaluar të rinj për shkak të mbajtjes së bluzave me simbole kombëtare, flamujve të Republikës së Serbisë apo motiveve fetare, gjë që policia e ka interpretuar si provokim.

Në fund të fjalës së tij, kryetari i komunës shprehu pritjen që shënimi i ardhshëm i Vidovdanit të kalojë në mënyrë të qetë dhe dinjitoze, si dhe që pjesëtarët e komunitetit serb të mund ta shënojnë pa pengesa këtë festë dhe të përdorin simbolet e tyre kombëtare në përputhje me të drejtat e garantuara me Kushtetutë, pa ndalime dhe incidente të tjera.

Kryesuesi e falënderoi kryetarin e komunës për fjalën e tij.

Pas kësaj, për fjalë u paraqit këshilltari Časlav Sofronijević. Ai shtroi pyetjen nëse Komuna e Zvečanit është e njoftuar me punimet që prej një kohe po zhvillohen në hapësirën e Dudin Krshit. Ai theksoi se në atë lokacion janë larguar deponitë ilegale, gjë që e vlerësoi si veprim pozitiv, duke u shprehur mirënjohje personave që kanë kryer pastrimin e asaj hapësire. Njëkohësisht theksoi se çdo investitor apo subjekt ekonomik që ushtron veprimtari në territorin e komunës duhet të veprojë në përputhje me dispozitat në fuqi dhe t'i realizojë aktivitetet e veta në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale.

Këshilltari Sofronijević në vazhdim shtroi pyetje lidhur me vendosjen e tabelave me emrat e rrugëve, duke theksuar se në hyrje të fshatit Malo Rudare është vendosur një tabelë me emrin e një

personaliteti shqiptar. Ai shprehu qëndrimin se gjatë përcaktimit të emrave të rrugëve nga pushteti i mëparshëm është dashur të merret parasysh struktura kombëtare e popullsisë së atij fshati, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një vendbanim me shumicë serbe. Ai shtoi se qytetarët i janë drejtuar me pyetje lidhur me emrin e përmendur të rrugës, për çka kërkoi sqarim për arsyet e vendosjes së asaj table në lokacionin e përmendur.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara, kryetari i komunës, dr. Dragiša Milović, theksoi se, sipas informatave të marra nga drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Ministria e Infrastrukturës qysh në vitin 2024 kishte shpallur thirrje publike për dhënien me qira të një parcele me sipërfaqe prej 6.800 m² në hapësirën e Dudin Krshit. Sipas informatave në dispozicion, lokacioni i përmendur është paraparë për ndërtimin e poligonit për trajnimin e kandidatëve të autoshkollave.

Kryetari i komunës theksoi se nuk ka njohuri nëse udhëheqja e mëparshme e komunës, kryetari i mëparshëm apo Kuvendi Komunal kanë qenë të njoftuar apo të konsultuar lidhur me atë procedurë. Ai shtoi se, sipas informatave që ka në dispozicion, Komuna e Zveçanit nuk ka asnjë përfitim financiar nga ai qiradhënie, ndërsa kontrata e qirasë është lidhur për një periudhë prej njëzet vjetësh, me mundësi vazhdimi.

Në vazhdim, kryetari i komunës sërish vuri në dukje problemin e centralizimit të tepruar të vendimmarrjes dhe kompetencave të kufizuara të vetëqeverisjes lokale. Ai veçanërisht theksoi se Komuna e Zveçanit ende nuk ka mundësi të shfrytëzojë mjetet nga buxheti i saj, sepse disa zyrtarë ende nuk i kanë marrë certifikatat e nevojshme, gjë që në mënyrë të konsiderueshme ngadalëson realizimin e projekteve infrastrukturore. Ai rikujtoi se për infrastrukturë janë planifikuar mjete të caktuara, por ato ende nuk janë në dispozicion për shfrytëzim.

Gjithashtu, ai theksoi se Komuna e Zveçanit disa herë ka kërkuar ndihmë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për tejkalimin e problemeve administrative. Ai rikujtoi se në periudhën e mëparshme punët buxhetore për Komunën e Zveçanit i ka kryer një komunë tjetër, ndërsa tani një zgjidhje e tillë nuk është pranuar. Ai shprehu pritjen që institucionet kompetente në periudhën e ardhshme të mundësojnë funksionimin pa pengesa të vetëqeverisjes lokale, në mënyrë që qytetarët të mund t'i realizojnë me kohë të drejtat e tyre dhe të shfrytëzojnë shërbimet e komunës.

Pas kësaj, për fjalë u paraqit këshilltari Ilir Peci. Ai iu referua disa projekteve infrastrukturore të realizuara në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2012, duke theksuar se, sipas njohurive të tij, disa projekte që në dokumentacion janë evidentuar si të përfunduara, në praktikë nuk janë realizuar plotësisht. Si shembuj përmendi disa rrugë, hapësira parkimi dhe punime infrastrukturore në disa fshatra, duke shprehur dyshim për mënyrën e realizimit dhe evidentimit të atyre projekteve.

Lidhur me deklaratimet e këshilltarit Peci, kryetari i komunës, dr. Dragiša Milović, theksoi se nuk e kishte vënë në pikëpyetje punën e udhëheqjes së mëparshme, por se kishte dhënë përgjigje vetëm për pyetjen konkrete që kishte të bënte me punimet në hapësirën e Dudin Krshit. Ai shtoi se ka

vizituar disa fshatra në territorin e komunës dhe se disa projekte të realizuara janë kryer me cilësi. Megjithatë, ai theksoi se infrastruktura në territorin e komunës në tërësi është e vjetruar dhe se nevojiten investime të reja. Gjithashtu tha se, nëse këshilltari Peci ka prova për projekte të caktuara që nuk janë realizuar, ndërkohë që në dokumente janë evidentuar si të tilla, këto prova duhet t'ia dorëzojë prokurorisë.

Meqenëse askush tjetër nuk u paraqit për fjalë, kryesuesi konstatoi se rendi i ditës është shteruar dhe e mbylli seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Zveçanit, e cila përfundoi në orën 11:51.

Në Zveçan,

Datë: 25.06.2026.

Procesmbajtësi:



Miloš Nedeljković, master jurist, asistent
administrativ i Kuvendit

Kryesuesi i Kuvendit të
Komunës së Zveçanit



Dr Srdan Milosavljević